



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME I AVOKATIT TË POPULLIT

A.nr. 826/2018

kundër

Policisë së Kosovës

lidhur me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike

Drejtuar: Z. Rashit Qalaj, Drejtor i Përgjithshëm
Policia e Kosovës

Kopje: Z. Baki Kelani, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun
Policia e Kosovës

Znj. Samira Kika, Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Diversitet
Policia e Kosovës

Prishtinë, më 26 prill 2019

Qëllimi i Raportit

1. Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes lidhur me ankesën e A. D. (ankuesi) për qasje në dokumente publike parashtruar kundër Policisë së Kosovës, analizimin e Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) përkitazi me ankesën në fjalë, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve/autoriteteve publike në raport me zbatimin e këtij ligji në rastet e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike. Raporti bazohet në faktet, provat, si dhe nga shkresat e lëndës, të cilat i ka Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP).

Baza kushtetuese dhe ligjore

2. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
3. Gjithashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 18, paragrafi 1, përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:
 - *“Të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre”* (pika 1);
 - *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla”* (pika 2);
 - *“të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave”* (pika 4);
 - *“të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit”* (pika 5);
 - *“t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta”* (pika 6);
 - *“të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryej hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës”* (pika 8);

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon t’i kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

Përshkrimi i çështjes

Dëshmitë dhe informatat të cilat i ka IAP-ja, të ofruara nga ankuesi dhe të evidentuara nga hetimi i bërë lidhur me rastin, përmbliidhen si në vijim:

4. Më 24 shtator 2018, ankuesi, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar PK-së me kërkesë për statistikat e gjobave të shqiptuara në komunikacion nga Policia e Kosovës, gjatë viti 2017, sipas llojit të shkeljes.
5. Më 25 shtator 2018, ankuesi, nëpërmjet postës elektronike, kishte pranuar përgjigje me të cilën është njoftuar për veprimet të cilat PK-ja i ka ndërmarrë nga fushëveprimi i saj në aspektin parandalues dhe në aspektin aktiv operacional, si dhe me tabelën me statistika për aksidentet dhe numrin e tiketave të shqiptuara nga PK-ja për periudhën janar - gusht 2017 dhe janar - gusht 2018. Në po të njëjtën ditë, ankuesi i është drejtuar përsëri PK-së me kërkesën që statistikat për gjobat e shqiptuara të zërthehen në detaje se për çfarë janë shqiptuar.
6. Më 9 nëntor 2018, bazuar në nenin 10 të LQDP-së, ankuesi ka parashtruar ankesë në IAP kundër PK-së, për shkak të kufizimit për qasje në dokumente publike, respektivisht për kufizimin e së drejtës për informim.
7. Nisur nga qëndrimi i ankuesit dhe PK-së në komunikimin e zhvilluar ndërmjet tyre, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit (AP), më 23 nëntor 2018, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar Zyrës për Informim e PK-së dhe Zyrës për të Drejtat e Njeriut dhe Diversitet e PK-së, duke kërkuar informata lidhur me kërkesën e ankuesit, përkatësisht nëse PK-ja ka mundësi t'i i zërthejë të dhënat e kërkuara sipas kërkesës së ankuesit.
8. Më 26 nëntor 2018, përfaqësuesja e AP-së ka marrë përgjigje nga Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Diversitet, përmes së cilët ata njoftojnë se ankuesi mund ta ripërsërisë kërkesën e tij në Zyrën për Informim e PK-së.
9. Më 27 nëntor 2018, Zyra për Informim e PK-së, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar ankuesit, duke iu referuar korrespondencës së zhvilluar lidhur me kërkesën e tij, në të cilën, ndër të tjera, thuhet se ata i janë përgjigjur kërkesës së tij fillestare, por për kërkesën shtesë pohojnë se e kanë përcjellë atë te departamenti kompetent, ndërkohë që e ftojnë atë që t'ua përcjellë dokumentin identifikues, duke përfshirë edhe qëllimin e përdorimit të informacioneve/statistikave.
10. Më 2 dhjetor 2018, ankuesi, duke iu referuar së drejtës së garantuar me LQDP, përkatësisht me nenin 1, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar PK-së, duke e njoftuar atë se vazhdon të kërkojë qasje në dokumentin e kërkuar, përkatësisht në të dhënat e kërkuara.
11. Më 5 dhjetor 2018, PK-ja i është drejtuar ankuesit nëpërmjet postës elektronike, duke e njoftuar atë se PK-ja e ka shqyrtuar kërkesën e tij për sqarime shtesë lidhur me zërthimin e të dhënave të dërguara. Për më tepër, e ka njoftuar ankuesin se nuk është kontestuese çështja e lejitimit të qasjes në të dhënat e kërkuara, por që kërkesën e ankuesit e konsiderojnë të pakompletuar/të paqartë, për shkak të mungesës së identifikimit të ankuesit. Po ashtu, PK-ja e ka njoftuar ankuesin me dispozitat e nenit 13 [Refuzimi i qasjes në dokumente zyrtare], paragrafi 1.1, të LQDP-së. Megjithatë, PK-ja ka shprehur gatishmëri për të dhënë sqarime shtesë, në mënyrë që ankuesi të mund të sigurojë informacionin/statistikat e kërkuara.

12. Më 6 dhjetor 2018, ankuesi i është drejtuar përsëri PK-së, duke i dhënë sqarimet e nevojshme për kërkesën e tij.
13. Më 11 dhjetor 2018, Policia e Kosovës i është drejtuar ankuesit nëpërmjet postës elektronike, të cilin e ka ftuar në Zyrën për Informim e PK-së (ZIMP-DPP-Prishtinë), për t'i marrë statistikën pas sqarimeve përfundimtare, në të kundërtën, kërkesa e tij do të mbetet e përcaktuar.
14. Më 15 dhjetor 2018, ankuesi i është përgjigjur PK-së, duke e njoftuar se qëndron pranë kërkesës që të dhënat e kërkuara t'ia dërgojnë, duke i njoftuar se nuk ka mundësi që të shkojë në zyrat e PK-së dhe kërkesën që ai të paraqitet në zyrat e PK-së e sheh si pengesë për realizimin e qasjes në të dhënat e kërkuara.
15. Më 17 dhjetor 2018, PK-ja, nëpërmjet postës elektronike, i është përgjigjur ankuesit vetëm duke e referuar në sqarimet e dhëna në korrespondencën e zhvilluar nëpërmjet postës elektronike.
16. Më 18 janar 2019, përfaqësuesja e IAP-së u takua me mbikëqyrësen e Zyrës për të Drejtat e Njeriut dhe Diversitetit të PK-së, nga e cila u njoftua se çështja në fjalë duhet të bisedohet me përfaqësuesin të Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e PK-së. Më 1 shkurt 2019, u realizua takimi me shefin e Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun dhe qëndrimi lidhur me kërkesën e ankuesit ishte i njëjti, sikur edhe në përgjigjen e PK-së drejtuar ankuesit, e datës 27 nëntor 2018.
17. Më 7 mars 2019, Avokati i Popullit iu drejtua me shkresë shefit të Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në PK, nëpërmjet së cilës, ndër të tjera, ia rikujtoi LQDP-në, e veçanërisht nenet 6, 7 dhe 11 të këtij ligji dhe ka kërkuar që të njoftohet me veprimet që do të ndërmerren, në mënyrë që çështja e ankuesit të trajtohet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
18. Më 15 mars 2019, Avokati i Popullit mori përgjigje nga shefi i stafit të Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, përmes së cilës, ndër të tjera, e njoftoi Avokatin e Popullit se PK-ja ka qenë e gatshme që, pas sqarimeve dhe sigurimit të dokumentacionit zyrtar, sipas procedurave të parapara, palës t'ia ofrojë statistikën e kërkuara, të zbërthyera për periudhën kohore të kërkuar, mirëpo kërkuuesi i dokumentit nuk ka shprehur vullnet që të kontaktojë me PK-në as nëpërmjet linjës telefonike, e as të takohet me zyrtarët e PK-së. Po ashtu, në këtë përgjigje ai vlerëson se kanë vepruar sipas dispozitave të parapara ligjore.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Kosovë

19. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm *Kushtetuta*), në nenin 41, paragrafi 1, parasheh të drejtën për qasje në dokumente publike, sipas të cilit definohet: *“Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.”*
20. Paragrafi 2 i po të njëjtit nen të Kushtetutës, përcakton se dokumentet e mbajtura nga të gjitha institucionet, janë të qasshme për të gjithë, me përjashtim të atyre dokumenteve qasja në të cilat është e kufizuar me ligj: *“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të*

kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”

21. E drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 19 i së cilës përcakton: *“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.”*
22. Lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) - [Liria e Shprehjes]: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”*
23. Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së: *“Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.”*
24. Neni 6 i LQDP-së [Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare] përcakton:
 - “1. Kërkesat për qasje në dokumente parashtrihen në çfarëdo mënyre e cila i mundëson institucionit publik të identifikojë dokumentin.*
 - 2. Kërkuesi i ndonjë dokumenti nuk është i obliguar që të japë arsye për të pasur qasje në dokumente.*
 - 3. Nëse kërkesa nuk është sa duhet e saktë, institucioni publik kërkon nga kërkuesi që ta qartësojë kërkesën dhe i ndihmon kërkuesit që ta bëjë këtë.*
 - 4. Kërkuesi i ndonjë dokumenti ka të drejtë për të mbetur anonim ndaj palëve të treta.*
 - 5. Institucionet publike i ofrojnë personave informata dhe ndihmë se si dhe ku mund të parashtrihen kërkesat për qasje në dokumente.*
 - 6. Formalitetet për kërkesa nuk tejkalojnë atë që është kyçe për të përpunuar kërkesën.”*
25. Neni 7, paragrafi 8, i LQDP-së thekson shprehimisht: *“Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtëm dhe informon kërkuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj.”*
26. Neni 11, paragrafi 1 [Format e qasjes në dokumente], i LQDP-së përcakton: *“Kur të lejohet qasja në dokument kërkuesi ka të drejtë të zgjedhë nëse do të kontrollojë origjinalin apo kopjen, ose për të pranuar një kopje të dokumentit në çfarëdo forme apo formati në dispozicion sipas zgjedhjes së tij.”*

27. Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke trajtuar parimin e administratës së hapur, në nenin 9, paragrafi 1, parasheh: “*Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.*”
28. Avokati i Popullit konstaton se përjashtimet e së drejtës për qasje në dokumente janë të përcaktuara në nenin 12 të LQDP-së. Informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe me Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.

Analiza e rastit dhe konstatimet e Avokatit të Popullit

29. Avokati i Popullit vëren se kërkesa e ankuesit për qasje në dokumente publike, e datës 24 shtator 2018, drejtuar PK-së, ka të bëjë me statistikën e gjobave të shqiptuara në komunikacion nga PK-ja, gjatë vitit 2017, sipas llojit të shkeljes. Më 25 shtator 2018, ai e kishte përsëritur kërkesën që statistikën për gjobat e shqiptuara të zërthehen se për çfarë janë shqiptuar. Këtë kërkesë, Zyra për Informim e PK-së e konsideron si kërkesë shtesë, përkundër asaj se përmbajtja e kërkesës që nga fillimi është e njëjtë.
30. Për më tepër, në sqarimin që PK-ja e jep në shkresën e datës 15 mars 2019 drejtuar AP-së, për “*Kërkesën-1*” dhe për “*Përgjigjen-1*”, thuhet se ankuesit i janë dhënë informacione dhe statistika më shumë se që ai ka kërkuar, meqë ato bëhen publike në ueb-faqen dhe në raportin vjetor të PK-së.¹ Megjithatë, përkundër faktit që të dhënat dhe informacionet e kërkuara nuk janë të dhëna të klasifikuara, të cilën gjë edhe PK-ja e pohon në shkresat e saj, ankuesit **nuk** i janë ofruar të dhënat dhe informacionet që ai i ka kërkuar. Atij i janë dhënë informacione të përgjithshme lidhur me veprimet që PK-ja i ka ndërmarrë nga fushëveprimi i saj në aspektin parandalues dhe në aspektin aktiv operacional, si dhe tabela me statistika për aksidentet dhe numrin e tiketave të shqiptuara nga PK-ja, për periudhën janar - gusht 2017 dhe janar - gusht 2018.
31. Më tutje, në shkresën e datës 15 mars 2019, në “*Përgjigjen-2*” për “*Kërkesën-2*”, thuhet se ankuesit i është dhënë përgjigje me informacione shtesë dhe përtej kërkesës së tij, porse për statistikën e zbërthyer, duke iu referuar nenit 31, pika 8, të Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, e ftojnë ankuesin që ta sjellë dokumentacionin e identifikimit, përfshirë edhe qëllimin e përdorimit.² Megjithatë, dispozita në të cilën thirret PK-ja nuk e kërkon legjitimitimin e palës dhe qëllimin e kërkesës. Për më tepër, kërkesa e ankuesit është: “*...statistikën e gjobave të shqiptuara në komunikacion nga Policia e Kosovës, gjatë vitit 2017, sipas llojit të shkeljes...*” Ndërsa, në sqarimin e PK-së për “*Kërkesën-2*” dhe për “*Përgjigjen-2*”, thuhet se, për rastin në fjalë, nuk janë dhënë sqarimet dhe arsyet/dokumentacioni nga pala kërkuese, të nevojshme për shfrytëzimin e të dhënave të kërkuara. Përkritazi me këtë, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në nenin 4 [E drejta e qasjes në dokumente], paragrafi 3, të këtij neni, i cili përcakton: “*Kërkesat e kërkuesit për qasje në dokumente publike, të parashtruara në cilëndo formë të lejuar me dispozitat e paragrafit paraparak të këtij neni, nga institucioni publik të cilit i drejtohet kërkuesi,*

¹ Shkresa e PK (nr.pr.01/0185, 14/03/2019) si përgjigje në shkresën e AP, të datës 15.3.2019, faqe 2.

² Po aty, faqe 2.

trajtohen të barabarta dhe zyrtare...”, që nënkupton se, pa marrë parasysh se cili është kërkuesi i dokumentit, përgjigja për kërkesën duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe zyrtare, pavarësisht se në çfarë forme kërkuesi e ka parashtruar kërkesën. Ndërsa, neni 6, paragrafi 1, përcakton: “Çdo kërkuesi i dokumentit, ka të drejtë në qasje të dokumenteve të institucioneve publike, duke iu përmbajtur parimeve, kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj.” Rrjedhimisht, nënkuptohet se identifikimi i kërkuetit nuk është i domosdoshëm, meqë mundësia e parashtrimit të kërkesës për qasje, në çfarëdo forme, mbetet e hapur³. Për autoritetin përgjegjës është e domosdoshme të qartësohet se çka apo cili dokument po kërkohet, por është jorelevante kush e kërkon, meqë trajtimi bëhet në parim dhe pa anime, barabartë dhe zyrtarisht. Parimisht, përshkallëzimi i lejimit për qasje në një dokument vendoset ligjërisht, në mënyrë që të parandalohet arbitrariteti në vendimin për lejimin ose jo për qasje.

32. Më tutje, në shkresën në fjalë,⁴ në “Përgjigjen-3” për “Kërkesën-3”, thuhet se PK-ja i është drejtuar ankuesit duke i dhënë sqarim të detajuar mbi veprimet zyrtare dhe duke e pohuar se nuk është kontestuese dhënia e statistikave. Në mënyrë që të shmangin keqkomunikimin, sipas PK-së, e ka ftuar ankuesin që t’i kontaktojë zyrtarët e PK-së nëpërmjet numrave të telefonisë mobile dhe fikse. Ndërsa në sqarim, te kjo pikë, thuhet se kërkuesi i dokumentit nuk ka qenë bashkëpunues. Avokati i Popullit tërheq sërish vëmendjen te neni 6, paragrafët 1 dhe 2, sipas të cilit, kërkuesi i dokumentit mund të paraqesë kërkesë në çfarëdo forme, mjaftueshëm që kërkesa të identifikojë dokumentin e kërkuar. Po ashtu, në rastin konkret, të dhënat e kërkuara nuk bëjnë pjesë në përjashtimet e përcaktuara në nenin 12 të LQDP-së. Për më tepër, nga korrespondenca e zhvilluar nëpërmjet postës elektronike mes PK-së dhe ankuesit, vërehet se kërkesa ishte e qartë dhe nuk ishte e ndërlikuar.
33. Në përmbyllje të shkresës, e datës 15 mars 2019,⁵ thuhet se PK-ja ka qenë e gatshme që, pas sqarimeve dhe sigurimit të dokumentacioneve zyrtare sipas procedurave të parapara, t’ia ofrojë të dhënat e kërkuara, të zbërthyera për periudhën kohore të kërkuar, por meqë PK-ja e konsideron që kërkuesi i dokumentit nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk ka shprehur vullnet për takim zyrtar, këto të dhëna nuk i janë përcjellë ankuesit. Avokati i Popullit konstaton se përgjigja dhe qëndrimi i PK-së është në kundërshtim me nenet 1, 6 dhe 11 të LQDP-së, si dhe me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Mosveprimi sipas dispozitave ligjore në fuqi përbën keqadministrim.
34. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së që, sipas nenit 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë. GjEDNj në rastin Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë (*Aplikimi nr. 37374/05*) vëren se, “[...]informacioni i kërkuar nga kërkuesi, në rastin konkret ishte i gatshëm dhe i disponueshëm (shih, a contrario, Guerra dhe të tjerët kundër Italisë, 19 shkurt 1998, § 53 in fine, Raporte të aktgjykimeve dhe vendimeve 1998-I) dhe nuk kërkonte

³ LQDP, neni 4, paragrafi 3.

⁴ Shkresa e PK (nr.pr.01/0185, 14/03/2019) si përgjigje në shkresën e AP, të datës 15.3.2019, faqe 2.

⁵ Po aty.

mbledhje të dhënash nga Qeveria. Ndaj, Gjykata konsideron se shteti kishte detyrimin të mos pengonte rrjedhën e informacionit të kërkuar nga kërkuesi.”(paragrafi 36)⁶

35. Më tej, GjEDNj-ja thekson se vonesat në dhënien e informatës mund t’ia heqin në mënyrë të vazhdueshme të gjithë vlerën informatës dhe interesimin lidhur me të, sepse një lajm përbën një shërbim që ikën shpejt dhe vonimi i botimit të tij, edhe për një periudhë të shkurtër kohore, mund t’ia mohojë lajmit tërë vlerën dhe interesin (shih rasti *The SundayTimes v. The United Kingdom*).⁷
36. Avokati i Popullit e vlerëson gatishmërinë e PK-së që të komunikojë me kërkuenin/zyrtarin dhe me IAP-në, por rithekson detyrimet ligjore që dalin nga legjislacioni në fuqi në funksion të transparencës dhe të demokracisë. Përgjegjësia për t’u përgjigjur në parashtrirat e ndryshme të qytetarëve, duke përfshirë edhe ato për qasje në dokumente dhe në informata zyrtare, ndër të tjera, theksohet edhe në aktgjykimin e GjEDNj-së për rastin *Observer And Guardian V. The United Kingdom*: “T’i mohosh publikut informacione mbi funksionimin e organeve të shtetit, do të thotë të shkelësh të drejtën themelore të demokracisë.”⁸
37. Nisur nga sa u tha më lart dhe me qëllim të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, si dhe rritjes së transparencës dhe të llogaridhënies, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, Avokati i Popullit i:


Rekomandon

Policisë së Kosovës

1. T’i ofrojë ankuesit qasje në të dhënat e kërkuara, pa e kushtëzuar atë që të paraqitet personalisht në zyrat e PK-së.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarrja lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

⁶ Rasti i *Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë* (Aplikimi nr. 37374/05, 14 prill 2009)

⁷ *Case Of The Sunday Times V. The United Kingdom*, (Application no. 6538/74, 26 April 1979)

⁸ *Case Of Observer And Guardian V. The United Kingdom*, (Application no. 13585/88, 26 November 1991)